VENDIM
Nr. 130, datë 13.5.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "5GX ENERGY" SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR CENTRALIN FOTOVOLTAIK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të nenit 6, të "Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 1276/3 prot., datë 11.5.2026, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë '5GX Energy' sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "5GX Energy" sh.p.k.

- Shoqëria "5GX Energy" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, i ndryshuar, për centralin fotovoltaik me kapacitet 10 mw, në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, qarku Fier dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 111, datë 10.6.2024.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "5GX Energy" sh.p.k. me shkresën nr. 1276 prot., datë 27.4.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

- ERE nëpërmjet *email*-it zyrtar datë 29.4.2026, të protokolluar në vijim me nr. 1276/1 prot., datë 29.4.2026, i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e pa plotësuar në këtë aplikim dhe në përgjigje, shoqëria me shkresën nr. 1276/2 prot., datë 5.5.2026 ka përcjellë të plotë informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaik për të cilin kërkohet regjistrimi, klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës, sipas nenit 6 të rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në kategorinë prodhues dhe tregtar i energjisë elektrike dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti